



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**ZL.Anr.390/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Nedzad Uglijanin, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Mitrovicës së Veriut, nga radhët e subjektit politik Iniciativa për Mitrovicën e Veriut, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 05.11.2025, merr këtë :

**V E N D I M**

**REFUZOHET E PABAZUAR** ankesa ZL.Anr.390/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar nga Nedzad Uglijanin, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Mitrovicës së Veriut, nga radhët e subjektit politik Iniciativa për Mitrovicën e Veriut, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

**A r s y e t i m**

Më datë 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.390/2025, nga Nedzad Uglijanin, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Mitrovicës së Veriut, nga radhët e subjektit politik Iniciativa për Mitrovicën e Veriut, me të cilën thekson se me datë 2 nëntor 2025, në faqen zyrtare të KQZ-së janë publikuar rezultatet përfundimtare ku shihet se të drejtë vote sipas listës kanë 17.667 votues, ndërsa në zgjedhjet për kuvendin komunal për vitin 2025 kanë marrë pjesë 8.149 votues që kanë votuar në të gjitha vendvotimet e komunës. Në të njëjtën faqe të KQZ-së, në pasqyrë tabelare është publikuar se sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2024, Mitrovica e Veriut ka pasur 7.920 banorë dhe se numri i anëtarëve të Kuvendit Komunal, në bazë të këtij regjistrimi të popullsisë është 15. Tutje thekson se KQZ-ja nuk e ka zgjedhur



në mënyrë sistematike mospërputhjen ndërmjet numrit të banorëve të regjistruar dhe listave zgjedhore- numrit të votuesve, dhe kjo mospërputhje ndikon drejtpërdrejt në rregullsinë e procesit zgjedhor. Është fakt i njohur se në katër komunat në veri të Kosovës me shumicë serbe, regjistrimi i popullsisë është zhvilluar vetëm pjesërisht, për shkak të bojkotit të regjistrimit nga komuniteti shumicë serb. Në komunën e Mitrovicës së Veriut, regjistrimi është bojkotuar plotësisht, meqë Lista Serbe ka bërë thirrje për bojkot. Si rezultat regjistrimi praktikisht ka munguar, dhe një regjistrim i tillë nuk mund të shërbejë si bazë për përcaktimin e numrit të banorëve rezidentë, e as për përcaktimin e numrit prej 15 anëtarësh për kuvend komunal. Tutje ka theksuar se kuvendi komunal i Mitrovicës së Veriut në të gjitha periudhat zgjedhore ka pasur 19 anëtar, si pasojë e zvogëlimit të numrit të anëtarëve të kuvendit komunal nuk ka mundur të zgjidhet si anëtar. Ka kërkuar nga PZAP ta pranojë ankesën si të bazuar dhe ta urdhërojë KQZ-në ta anuloi vendimin për numrin e anëtarëve në kuvend dhe ta zbatojë ligjin nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, përkatësisht nenin 36.1 dhe 36.1 pika (B).

Ankesës i ka bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit.

Në përgjigjen në ankesë dërguar nga KQZ-ja, me datë 05.11.2025, thekson se bazuar në dispozitat ligjore në Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjegjësisht neni 119 i LZP-së, përcakton se PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj. Nga interpretimi i dispozitave ligjore Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nuk parashihet me asnjë dispozitë ligjore se mund të ankimohen vendimet e kësaj natyre të KQZ-së, konkretisht numri i anëtarëve në kuvendin komunal, nuk hy në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP. Numri i anëtarëve të kuvendit komunal në cdo komunë përcaktohet nga Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. KQZ para shpalljes së datës së zgjedhjeve lokale nga Presidentja e Republikës së Kosovës, me datën 15.05.2025 ka dërguar kërkesë për informatë të MAPL, të cilët kanë theksuar se caktohet numri i anëtarëve të kuvendit komunal në raport me numrin e banorëve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

***-Ankesa është e pabazuar.***

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e parashtruar nga Nedzan Ugljanin, kandidat për anëtarë të kuvendit

komunal në Komunën e Mitrovicës së Veriut, nga radhët e subjektit politik Iniciativa për Mitrovicën e Veriut, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, me pretendimet se pas KQZ-ja nuk e ka përcaktuar në mënyrë të drejtë dhe sistematike numrin real të banorëve të Mitrovicës së Veriut ku si pasojë e ka bërë zvogëlimin e numrit të anëtarëve të kuvendit komunal, Paneli vlerësoi se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë se ka pasur mospërputhje të numrit të banorëve me listat votuese dhe si shkak i kësaj mospërputhje është zvogëluar numri i anëtarëve për kuvend komunal, në ankesë nuk ka bashkëngjitur provë konkrete me të cilën i dëshmon pretendimet e tij, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se këto pretendime nuk janë faktuar me prova konkrete.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

ZL.Anr.390/2025 më datën 05.11.2025

**Kryesues i Panelit**

**Bujar Muzaqi**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.112/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha, kryetar, Faton Ademi dhe Lumni Sallauka, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesës Nedzad Ugljanin, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovicës së Veriut, nga radhët e Subjekti Politik Iniciativa për Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve( KQZ), me seli në Prishtinë, me numër 01/3093-2025 dt.3.11.2025, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, për anëtarë të Kuvendit Komunal, të mbajtura më dt.12 Tetor 2025, duke vendosur sipas ankesës së Nedzad Ugljanin, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZL.Anr.390/2025 të datës 5.11.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.11.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e parashtruar nga Nedzad Ugljanin, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovicës së Veriut, nga Subjekti Politik Iniciativa për Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.390/2025 të datës 5.11.2025.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa (PZAP) ZL. Anr.390/2025 të datës 05.11.2025, është vendosur të refuzohet e pabazuar ankesa ZL. A.nr.390/2025 e datës 04.11.2025, e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovicës së Veriut



Nedzad Uglanin, nga Subjekti Politik Iniciativa për Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër vendimit me numër 01/3093-2025 dt.3.11.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më dt.12 Tetor 2025.

Kandidati i sipër përmendur për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovicës së veriut, më datën 4.11.2025, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me numër si më lartë, dt. 05.11.2025, në Gjykatën Supreme ka paraqitur ankesë, me të cilën konteston ligjshmërinë e vendimit të përmendur, duke propozuar që ankesa të pranohet, dhe Gjykata Supreme të aprovoj ankesën e tij, dhe çështjen ta kthejë për rishqyrtim dhe t'a urdhërojë Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që të rivlerësojë vendimin duke përcaktuar numrin e banorëve rezident në bazë të burimeve statistikore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në përgjigje të ankesës, qëndroi në konstatimet e paraqitura në vendimin e vet, dhe propozoi që ankesa të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të vendimit të atakuar pretendimeve ankimore dhe atyre në përgjigje në ankesë, shqyrtoi shkresat e tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se Nedzad Uglanin kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovicës së Veriut, nga Subjekti Politik Iniciativa për Mitrovicën e Veriut, kundër vendimit me numër 01/3093-2025 i datës 03.11.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2025, për Kuvendin Komunal, ka paraqitur ankesë Anr.390/2025 më datë 04.11.2025, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP).

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me vendimin ZL.Anr.390/2025 të datës 05.11.2025, ka vendosur të refuzohet e pabazuar ankesa Anr.390/2025, e paraqitur nga kandidati i sipër përmendur për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovicës së Veriut, duke vendosur më detajisht si në dispozitiv të vendimit të përshkruar më lart.

Në arsyetimin e tij PZAP, theksohet se, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës konstatoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar prova apo dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, por vetëm thekson në të, se më dt.2 nëntor 2025, në faqen zyrtare të KQZ-së, janë publikuar rezultatet përfundimtare ku shihet se të drejtë vote sipas





listës kanë 17.667 votues, ndërsa, në zgjedhjet për kuvendin komunal për vitin 2025 kanë marrë pjesë 8.149 votues që kanë votuar në të gjitha vendvotimet e komunës. Në të njëjtën faqe KQZ-së, në pasqyrën tabelare është publikuar se sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2024, Mitrovica e Veriut ka pasur 7.920 banorë dhe se numri i anëtarëve të Kuvendit Komunal, në bazë të këtij regjistrimi të popullsisë, është 15. Tutje thekson se KQZ-ja nuk e ka zgjedhur në mënyrë sistematike mospërputhjen ndërmjet numrit të banorëve të regjistruar dhe listave zgjedhore – numrit të votuesve dhe kjo mospërputhje ndikon drejtpërdrejtë në rregullsinë e procesit zgjedhor. Është fakt i njohur se në katër komunat në veri të Kosovës me shumicë Serbe, regjistrimi i Popullsisë është zhvilluar vetëm pjesërisht, për shkak të bojkotit të regjistrimit nga komuniteti shumicë Serb. Në komunën e Mitrovicës së Veriut, regjistrimi praktikisht ka munguar dhe një regjistrim i tillë nuk mund të shërbejë si bazë për përcaktimin e numrit të banorëve rezident, e as për përcaktimin e numrit prej 15 anëtarësh të kuvendit komunal. Tutje, ka theksuar se kuvendi komunal i Mitrovicës së Veriut ka pasur 19 anëtarë, ndaj, si pasojë e zvogëlimit të këtij numri nuk ka mundur të zgjidhet si anëtarë, i ka propozuar PZAP-it ta pranojë ankesën si të bazuar, me propozimin e theksuar si më lartë.

Në përgjigjen në ankesë dërguar KQZ-së, dt.5.11.2025, theksohet se bazuar në dispozitat ligjore në Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjegjësisht neni 119 i LZP-së, përcakton se PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuar shprehimisht me këtë ligj. Në interpretim të dispozitave të ligjit të sipër përmendur dhe të atij për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Ligji Nr.03/L-072, nuk parashihet me asnjë dispozitë ligjore se mund të ankimohen vendimet e kësaj natyre të KQZ-së, konkretisht numri i anëtarëve në kuvendin komunal, nuk hyn në kategorinë e vendimeve të KQZ-së, të cilat mund të ankimohen në PZAP. Numri i anëtarëve të kuvendit komunal në çdo komunë përcaktohet nga Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 36 par.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. KQZ para shpalljes së datës së zgjedhjeve lokale nga Presidentja e Republikës së Kosovës, më dt.15.05.2025, ka dërguar kërkesë për informatë të MAPL, të cilët kanë theksuar se caktohet numri i anëtarëve të kuvendit komunal në raport me numrin e banorëve ( shkresa me nr.prot.02/985-2025 – shkresa njoftuese e MAPL), nga të cilat rezulton se numri i anëtarëve të Kuvendit të kësaj Komune është 15 anëtarë. Ndaj, PZAP, pretendimet rreth numrit të anëtarëve të kuvendit komunal të komunës në fjalë, të parashtruesit të ankesës, nga arsyet e sipër theksuara, i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe si të tilla i ka refuzuar



si të pa bazuara në prova dhe dëshmi bindëse, andaj, në mbështetje të dispozitave të nenit 117 par.3 lidhur me nenin 118 par.1 të LZP-së, ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, sipas të cilit ankesa e paraqitur nga këtu ankuesi, është e pa themeltë dhe vendosja si në dispozitiv të vendimit, kur është refuzuar ankesa e parashtruesit, me pretendimet e sipër përmendura, është i drejtë dhe i ligjshëm, për faktin se ankuesi nuk ka qenë në gjendje të argumentoi, në bazë të provave përkatëse, a dëshmive bindëse, se vendimi i ankimuar i më lartë cekur i PZAP-së, është i kundërligjshëm.

Nga sa u theksua më lartë, rezulton katërçipërisht se çështja e numrit të anëtarëve të kuvendit komunal në çdo komunë, në Republikën e Kosovës, përcaktohet në mënyrë të specifikuar dhe shprehimisht nga Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal, kjo, bazuar në dispozitën e nenit 36 par.1, pikat a)... deri.... g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ku veç tjerash, në pikën a), shprehimisht theksohet se “nëse komuna i ka deri 10.000 qytetarë, kuvendi i asaj komune përbëhet prej 15 anëtarëve,” sikundër edhe është rasti konkret juridik.

Prandaj, nga këtu, kjo gjykatë, konsideron se në rastin konkret juridik, është marrë vendim i drejtë, me të cilin nuk është bërë diskriminim dhe lidhur me rastin konkret nuk është cenuar e drejta zgjedhore dhe ndonjë e drejtë themelore e paraparë me Ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk janë cenuar parimet themelore të procesit zgjedhor të parapara shprehimisht me nenin 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe me dispozitat përkatëse të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Për arsyet e paraqitura më lart, e në pajtim me nenin 118 pika 4 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
AA.nr.112/2025, datë 10.11.2025

Kryetar i kolegjit, gjyqtari  
Mr.Sc.Muhamet Rexha



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik  
*[Signature]*





GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LJICNO DOSTAVLANJE

Sheji i shkresës  
Oznaka spisa:

AA-112/2025

1. Pasi marrësi, I cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dëshitë të bëhet dorëzimi I sa pas lënjes së lajmerimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendët në kohën e caktuar në banesë apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndëresës, fëmijë, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca ( prbljeno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më \_\_\_\_\_ 201\_\_\_\_ në ora \_\_\_\_\_ cas.  
dana \_\_\_\_\_ u \_\_\_\_\_  
Shkaku i refuzimit të marrjes  
Razlog odbijanja prijmea

Nënshkrimi i dorëzuesit - poipis dostavljaoca

(Te panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebuje precrtati)

Emri i shkresës që dorëzohet:  
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIGYKUH 10.11.2025

Numri i shtojcave:  
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur  
më (me fjalë)  
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma  
( i slovima )

11.11.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që  
e ka marrë aktin në vend të tij  
Poipis primioa ili lica koje je  
pismeno primilo u zamenu)

V.SH 11.03

Nënshkrimi i dorëzuesit - poipis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruarë  
dorzuesit, duke shkruar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e ve  
Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se poipise, poipisuje ga dostavljaoc  
napomenom zasto primilac nije stavio svoj poipis.